

VENDIM
Nr.242, datë 16.4.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 9 të shtohen pikat 9/1, 9/2, 9/3 dhe 9/4 me këtë përmbajtje:

“9/1. Për zhvillimin e trajnimeve, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), lidh me referuesit (trajnerët) një apo disa nga tipet e këtyre kontratave:

- a) Kontratë për trajnimin e referuesve;
- b) Kontratë për trajnimin e nëpunësve të administratës publike;
- c) Kontratë për hartimin e kurrikulave dhe të materialeve të tjera trajnuese.

9/2. a) Tarifat e pagesës për referuesit (trajnerët) përcaktohen në kontratë dhe llogariten në bazë ditore, në varësi të kategorisë së referuesit (trajnerit).

b) Për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 9/1, tarifa ditore e plotë të paguhet për zhvillimin e 6 orëve trajnim, sipas tabelës nr.1 të lidhjes, që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Për kontratat e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 9/1, tarifa ditore e plotë të paguhet për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve trajnim, sipas tabelës nr.2 të lidhjes, që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, apo të trajnimit për më pak se 6 orë trajnim, pagesa të llogaritet në përpjestim me orët e trajnimit.

9/3. Referuesit (trajnerët) ndahen në tri kategori, si më poshtë vijon:

a) Referues (trajnerë) të kategorisë së ulët janë referuesit, të cilët kanë deri në pesë vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

b) Referues (trajnerë) të kategorisë së mesme janë referuesit, të cilët kanë një përvojë pune nga 5 deri në 10 vjet në fushën përkatëse ose kanë një diplomë master a të barasvlefshme me të.

c) Referues (trajnerë) të kategorisë së lartë janë referuesit, të cilët kanë mbi 10 vjet përvojë pune në fushën përkatëse ose kanë një gradë shkencore.

9/4. Shpenzimet për realizimin e trajnimeve të mbulohen nga buxheti i miratuar për Institutin e Trajnimit të Administratës Publike.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA A

Tarifat e pagesave për referuesit (trajnerët)

Tabela nr.1

Kategoria e referuesve (trajnerëve)	Tarifat ditore/lekë
I ulët	4500
I mesëm	6000
I lartë	9000

Tabela nr.2

Kategoria e referuesve (trajnerëve)	Tarifat ditore/lekë
I ulët	7200
I mesëm	9000
I lartë	13 000